

## **Thirrje Për Aplikime** **Për Trajnim Për Ngritje Të Kapaciteteve Për** **Organizatat E Shoqërisë Civile**

**Prishtinë**  
Departamenti i Demokratizimit  
Seksioni për Pjesëmarrje Publike

Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) fton përfaqësuesit e organizatave të vogla dhe të mesme të shoqërisë civile (OSHC) të marrin pjesë në një program trajnimi për ngritjen e kapaciteteve, me qëllim (i) rritjen e njohurive dhe pajtueshmërinë me kornizën ligjore dhe administrative në fuqi, (ii) ngritjen e kapaciteteve në hartimin e dokumenteve kyçe të brendshme cilësore, (iii) përmirësimin e aftësive të menaxhimit dhe raportimit financiar, (iv) forcimin e shkathtësive të avokimit dhe partneriteteve ndërsektoriale, si dhe (v) përmirësimin e komunikimit me mediat.

### Sfondi dhe Arsyeshmëria e Programit Të Trajnimit:

Bazuar në shembujt e suksesit dhe mësimet e nxjerra nga trajnimi i ofruar në vitin 2022, Misioni i OSBE-së në Kosovë vazhdon të rrisë kapacitetet e OSHC-ve të vogla dhe të mesme lokale në Kosovë. Me përfundimin e trajnimit, OSHC-të pjesëmarrëse do t'i përforcojnë kapacitetet e tyre të brendshme në fushat vijuese:

- Përshtatja e ciklit të menaxhimit të projekteve për t'u ndihmuar OSHC-ve të vogla dhe të mesme t'i formulojnë deklaratat e misionit të tyre, të hartojnë plane strategjike dhe të masin arritjet e tyre;
- Hartimi i PSV-ve të brendshme që synojnë ngritjen e efikasitetit dhe rezultojnë me performancë më të mirë, si dhe komunikim më të mirë së brendshmi e së jashtmi;
- Rritja e aftësive të menaxhimit financiar, me qëllim të rritjes së qëndrueshmërisë financiare të organizatës;
- Rritja e pajtueshmërisë së OSHC-ve me kornizën ligjore në fuqi, për t'u ndihmuar atyre në tejkalimin e vështirësive për qasje në fondet publike në dispozicion në nivel ministror dhe lokal dhe për të siguruar pajtueshmëri me rregulloret administrative/financiare në fuqi;
- Rritja e aftësive të avokimit me synimin për t'u ndihmuar OSHC-ve që të ndërtojnë partneritete ndërsektoriale me OSHC-të tjera dhe palët përkatëse;
- Rritja e aftësive komunikuese me qëllim rritjen e bashkëpunimit me median.

## Pasqyra e Trajnimit:

Trajnimi do të përbëhet nga katër modulet vijuese:

- I. Moduli i Parë (Dita 1) - **Hartimi i dokumenteve të brendshme cilësore**  
*Trajnim gjysmëditor me shembuj praktikë të dokumenteve të brendshme, si mandati i organizatës dhe PSV-të;*
- II. Moduli i dytë (Dita 1) - **Rritja e pajtueshmërisë së OSHC-ve me kornizën ligjore në fuqi**  
*Trajnim gjysmëditor me ushtrime praktike mbi përdorimin e menaxhimit financiar dhe raportimit financiar;*
- III. Moduli i tretë (Dita 2) - **Si të avokohet me sukses dhe të ndërtohen partneritete me OSHC-të tjera dhe palët përkatëse**  
*Trajnim gjysmëditor me ushtrime praktike për zhvillimin e iniciativave avokuese dhe ndërtimin e partneriteteve;*
- IV. Moduli i katërt (Dita 2) - **Rritja e komunikimit me median**  
*Trajnim gjysmëditor me ushtrime praktike me praktikantët më të mira të komunikimit dhe koordinimit me mediat e ndryshme.*

Secili modul trajnimi do të mbahet me prezencë fizike, dhe do të zhvillohet në gjuhën shqipe/serbe/angleze. Gjatë programit të trajnimit do të respektohen të gjitha masat për mbrojtje nga COVID-19.

## Kohëzgjatja e Trajnimit:

Trajnimi do të zgjasë dy ditë. Për t'i mbuluar të gjitha OSHC-të që veprojnë në nivel lokal në mbarë Kosovën, do të mbahen tre sesione të të njëjtit trajnim sipas orarit vijues:

05-06 qershor – për OSHC-të nga rajonet e Gjilanit dhe Prizrenit

08-09 qershor – për OSHC-të nga rajonet e Pejës dhe Prishtinës

13-14 qershor – për OSHC-të nga Mitrovica e Veriut dhe ajo e Jugut

Njohuritë e pjesëmarrësve mbi temat e propozuara do të vlerësohen para dhe pas programit të trajnimit. Vetëm pjesëmarrësit të cilët e ndjekin trajnimin gjatë tërë kohëzgjatjes së tij do të pajisen me certifikatë përfundimi.

**Inkurajohen fuqimisht që të aplikojnë përfaqësuesit e OSHC-ve të themeluara në zonat e banuara me komunitete joshumicë dhe që punojnë me të rinjtë, gratë dhe grupet e cënueshme.**

## **Kriteret e Kualifikimit dhe Procesi i Përzgjedhjes:**

Aplikuesit duhet të përfaqësojnë dhe të nominohen nga organizatat e shoqërisë civile (OSHC) që janë të regjistruara ligjërisht në Kosovë dhe aktive në rolin e tyre.

Kualifikimi i apliuesve dhe kriteret mbi të cilat do të përzgjidhen pjesëmarrësit janë si më poshtë:

- **Zona gjeografike** – Përfaqësuesit e OSHC-ve që veprojnë në zona të banuara kryesisht nga komunitetet joshumicë do të kenë prioritet;
- **Madhësia e OSHC-së** – Vetëm përfaqësues të OSHC-ve të vogla dhe të mesme, buxheti i të cilave nuk i kalon 50.000 euro, do të merren parasysh.
- **Përvoja e punës** – Trajnimi është i dedikuar për përfaqësues të OSHC-ve të cilat nuk kanë fare ose kanë pak përvojë në: (i) pajtueshmërinë me dhe zbatimin e kornizës ligjore dhe administrative në fuqi, (ii) hartim të dokumenteve kryesore të brendshme cilësore, (iii) menaxhim dhe raportim financiar, (iv) avokim dhe komunikim me mediat.
- **Fushëveprimtaria** – Përparësi do t'u jepet OSHC-ve të angazhuara në fushat vijuese: (i) pjesëmarrja publike e grupeve të komuniteteve joshumicë, veçanërisht të rinjve dhe grave, (ii) pjesëmarrja publike e të rinjve, (iii) përfshirja dhe pjesëmarrja publike e grupeve të cënueshme, përfshirë personat me aftësi të kufizuara dhe (iv) fuqizimi i grave.

## **Kriteret e Aplikimit:**

Nëse jeni të interesuar për këtë mundësi trajnimi dhe i plotësoni kriteret e mësipërme, ju lutemi paraqisni sa vijon:

1. Një CV dhe një letër motivuese ku duhet të sqaroni se si organizata juaj do të përfitonte nga ky program trajnimi.
2. Një përshkrim të vizionit, misionit dhe aktiviteteve/programeve të realizuara nga organizata në dy vitet e fundit, duke përfshirë sa vijon:
  - Mbulimin gjeografik, d.m.th. ku është themeluar organizata dhe ku vepron;
  - Numri i punonjësve me afat të caktuar dhe/ose vullnetarëve;
  - Të ardhurat vjetore për dy vitet e fundit;
  - Përshkrim i fushave specifike të punës dhe të përfituesve;
  - Përshkrim i trajnimeve specifike, nëse ka të tilla, që i kanë ndjekur anëtarët/punonjësit tuaj gjatë vitit të kaluar;
  - Përshkrim i bashkëpunimeve/partneriteteve përkatëse me OSHC-të e tjera/palët përkatëse që organizata juaj ka krijuar tashmë;
  - Përshkrim i shkurtër i projekteve në vazhdim e sipër, duke përfshirë burimin e financimit;
  - Informatat e kontaktit (numri i telefonit dhe adresa e emailit).

*Përshkrimi nuk duhet të jetë më i gjatë se dy faqe.*

3. Certifikatën e regjistrimit që dëshmon se organizata juaj është e regjistruar ligjërisht në Kosovë, dhe që është ende funksionale.

Procesi i përzgjedhjes do të bëhet në dy hapa:

- **Hapi 1** – Bazuar në shqyrtimin e CV-ve, letrave motivuese, përshkrimit të organizatave dhe dokumenteve ligjore të paraqitura, do të krijohet lista e ngushtë e aplikuesve të përshtatshëm;
- **Hapi 2** – Aplikuesit e përzgjedhur në listën e ngushtë do të ftohen për intervistë, si hap i fundit i procesit të përzgjedhjes.

Gjithsej **51 aplikues të suksesshëm** (17 për një seancë trajnimi) do të zgjidhen për programin e trajnimit.

Aplikuesit e suksesshëm duhet t'i ndjekin që të katër modulet e trajnimit. Meqenëse vëmendje e konsiderueshme në program do t'i kushtohet ndërtimit të partneriteteve dhe përpjekjeve të përbashkëta avokuese, aplikuesve do t'u kërkohet të angazhohen në diskutime dhe këmbim mendimesh me njëri-tjetrin.

Ju lutemi të dërgoni pakon e aplikimit në adresën vijuese të emailit: [Dafina.Bajrami@osce.org](mailto:Dafina.Bajrami@osce.org), duke cekur në rubrikën e titullit të emailit: *Aplikim për trajnim për ngritjen e kapaciteteve të OSHC-ve*.

Ju lutemi vini re se aplikacionet që nuk janë në përputhje me të gjitha udhëzimet e cekura më sipër nuk do të merren parasysh.

**Ju lutemi të dorëzoni aplikacionin më së voni deri në 00:00h sipas zonës kohore CET, 07 maj 2023.**

OSBE-ja është e përkushtuar për arritjen e diversitetit, andaj aplikuesit nga radhët e të gjitha komuniteteve, gjinive, moshave të ndryshme, si dhe personat me aftësi të kufizuar inkurajohen të aplikojnë.

#### **SHËNIM<sup>1</sup>:**

Pjesëmarrësit do të përzgjidhen në bazë të kritereve të përcaktuara në thirrjen për aplikime dhe cilësinë e aplikacioneve të dorëzuara, duke mbajtur parasysh barazinë gjinore, diversitetin dhe baraspeshën gjeografike.

**Ju lutemi vini re se të gjithë pjesëmarrësit e përzgjedhur për të marrë pjesë në trajnim do të njoftohen me email më së voni deri më xx maj 2023 (të konfirmohet).**

Çdo pyetje eventuale mund të drejtohet në adresat e mëposhtme të emailit:

[Boris.Sekulic@osce.org](mailto:Boris.Sekulic@osce.org) / [Dafina.Bajrami@osce.org](mailto:Dafina.Bajrami@osce.org)

---

<sup>1</sup> Ju lutemi vini re se duke i ofruar të dhënat tuaja personale, ju jepni pëlqimin tuaj që Misioni i OSBE-së në Kosovë (OSBE) t'i mbledhë, përpunojë, ruajë dhe transferojë të dhënat tuaja sipas nevojës për qëllime të këtij aktiviteti. Të dhënat personale që jepni do të përdoren për të shtyrë përpara mandatin e OSBE-së, i cili përfshin zhvillimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe monitorimin, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut. Të dhënat tuaja personale mund të përdoren brenda organizatës për qëllime të këtij trajnimi. Ato mund të përdoren edhe jashtë organizatës për qëllimin e vetëdijesimit publik për këtë trajnim; megjithatë, informatat nuk do të ndahen jashtë OSBE-së pa pëlqimin tuaj.